



PREPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr. 03-342

21.11. 2022

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) alinea 20 dhe neni 23 paragrafi (1) alinea 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji i njëjtë, pika 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.бp.10-4065/1 datë 2.11.2022, dhe në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-4270/11 datë 18.11.2022, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 42-të mbajtur më 18.11.2022, miratoi si në vijim:

Vendim për marrje masë – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles, për shkelje e kryer të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), në mënyrë që në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 10 tetor 2022, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, por edhe as gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, e transmetuar në kohën nga ora 7,00 deri në 19,00.
Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-4065/1 datë 2.11.2022, si pjesë përbërëse e këtij Vendimi si Shojcë nr.1.
2. DETYROHET SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Vendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat të LSHMAAV.
3. Pas mbarimit të afatit i përcaktuar në pikën 2 të këtij Vendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, përcaktuar në pikën 1 të këtij Vendimi, vepron sipas Vendimit.
4. Ky Vendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e regjistrimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është e detyruar të kryej mnikëqyrje kontrolli (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimit mediatik audiovizual sipas kërkesës, si dhe të pakove programore që i ritransmetojnë operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik në aspektin e respektimit të dispozitave nga Ligji i cituar, lejeve, vërtetimeve të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) alinea 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmorri masë-vendim për vërejtje publike në rastet kur kemi të bëjmë me mosrespektim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore bazuar në Ligjin e njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve përcaktuar me leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV, Shoqërit Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbime programore televizive detyrohen që gjatë ditës të transmetojnë së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuale maqedonase, ndërsa shërbimi transmetues publik së paku 40%. Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbime programore detyrohen që të paktën gjysmën e obligimeve përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni t'i realizojnë në periudhën nga ora 7,00 deri në 19,00.

Në kuadër të kompetencave të saja Ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 2-nëntor 2022., ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) nda shërbimit programor televiziv SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles, transmetuar më 10 tetor 2022., në nivel lokal, ku konstatoi shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV, në mënyrë që transmetuesi nuk ka transmetuar 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, por edhe as gjysmën e minimumit Ligjor të paraparë për program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, transmetuar në kohën prej orës 7,00 deri në 19,00. Gjegjesisht, nga mbikëqyrja u konstatuase më 10 tetor 2022, shërbimi programor televiziv i SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles, transmetonte 5 orë 43 minuta dhe 39 sekonda program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që është 25.36% nga totali i programit të transmetuar gjatë një dite e cila hyn në përlllogaritjen për program të krijuar burimor prej (22orë 35 minuta dhe 13 sekonda). Minimumi Ligjor prej 30% për transmetim të programit të krijuar burimor gjatë një dite, në lidhje

me totalin e programit të transmetuar më 10 tetor që hyn në llogaritje për program të krijuar burimor (22:35:13), është 6orë 46 minuta dhe 33 sekonda,. SHTR ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles transmetonte për 1 orë 2 minuta dhe 39 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase. Gjysmën e minimumit Ligjor (nga 06:46:33) dhe 3 orë 23 minuta dhe 16 sekonda program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, më pak se programi që duhej të transmetohet nga SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles, në periudhën nga ora 7:00 deri në 19:00. Në këtë periudhë, siç u konstatua nga mbikëqyrja, janë transmetuar 3 orë 2 minuta dhe 53 sekonda program i krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që në këtë rast është për 20 minuta dhe 23 sekonda më pak se minimumi i nevojshëm. Shkelja nga pika 1 e këtij Vendimi, është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4065/1 datë 2.11.2022, si pjesë përbërëse e këtij Vendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles më 4.11.2022., dërgoi Shkresë ark.nr.10-4065/2 datë 4.11.2022., me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4065/1 datë 2.11.2022, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoi deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit më 4.11.2022. Në afatin e paraparë, SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles nuk u deklarua për shkeljen e kryer të Ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 18.11.2022., pasi shqyrtoi Raportin me shkrim, konkludoi se SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles t'i shqiptoi masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) aline 20 dhe neni 23 paragrafi (1) aline 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji i njëjtë, pika 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-6039/1 datë 20.10.2015.dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr. 10-4065/1 datë 2.11.2022, për arsye të konstatimit për mosrespektim të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Vendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 42-të mbajtur më 18.11.2022., në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-4270/11 datë 18.11.2022., miratoi Vendim ku publikisht paralajmëron SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles dhe detyrohet, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga LSHMAAV. Pas mbarimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Vendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli , për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij Vendimi, veproi sipas Vendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër tij transmetuesi ka të drejtë që të parashtrojë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padi për ngritje të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së Vendimit.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, u mor vendimi si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-4065/1 datë 2.11.2022.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele,
Kryetar i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padi për ngritje të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Dorëzuar:

- SHTR ZV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles;
- Udhëheqësit të SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles;
- Personit përgjegjës të programit në SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles;
- Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike;
- Sektorit për çështje programore; dhe
- Personat e emëruar në Agjenci për udhëheqjen regjistrit PA1.